

UDHËZIM
Nr. 3, datë 1.8.2025

**PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 7, DATË 12.4.2023,
“PËR MIRATIMIN E TREGUESVE DHE KRITEREVE QË DUHET TË ARRIJNË
SUBJEKTET QË OFROJNË SHËRBIME NË SEKTORIN E UJËSJELLËS-
KANALIZIMEVE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës“i”, të pikës 13, të vendimit nr. 431, datë 11.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në shtojcën nr. 1, të udhëzimit nr. 7, datë 12.4.2023, “Për miratimin e treguesve dhe kritereve që duhet të arrijnë subjektet që ofrojnë shërbime në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve”, pika 12 “Miratim Plan Biznesi 5-vjeçar”, hiqet.

2. Pas pikës 3, të udhëzimit, shtohet pika 3/1 me përmbajtje si më poshtë:

“3/1. Subjektet që ofrojnë shërbime në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, çdo 5 vjet duhet të miratojnë Planin e Biznesit.”.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqëritë ujësjellës-kanalizimeve.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku